



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.781/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, Arafat Basha nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kastriot, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kamenices, Arafat Basha nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kastriot.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë dega në Kastriot, në Vendvotimin nr: 1024D/01R .

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 09.11.2017 në ora 16:50, nga Arafat Basha, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Kamenices, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kastriot, të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit QV nr. 1024D/01R, pas rinumërimit të votave nga KQZ-ja nga 1 votë që e kanë pasur më herët, më kanë dalur 7 vota, prandaj PZAP-it i ka kërkuar qendrën e votimit nr. 1024D/02R kanë votuar familjar të ngushtë dhe ka deklaruar se janë të gatshëm të dëshmojnë për votimin e tyre. Më tutje ka shtuar se në vendvotimin nga vëzhguesja Anila Salihu nga radhët e subjektit politik LDK, me datë 22.10.2017 në ora 22:30 përmes telefonit ka pranuar një sms dhe se deri në atë kohë kanë pasur 3 vota, duke theksuar se votat me postë nuk më figurojnë.

Në cilësi të provave si dëshmi ka bashkangjitur mesazhin e sms të dërguar nga vëzhguesja Anila Salihu Koretin dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve FRK.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet e parashtruara ne apel dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet e parashtruara ne apel janë të bazuara për faktin se nga provat dhe shkresat e lëndës, ka konstatuar se në vendvotimin 1024D/02R gjatë numërimit të votave kandidatit me nr.16 nga radhët e subjektit politik LDK ka patur parregulsi gjate procesit te numërimit te votave ne vendvotimet e sipërcituara dhe mbi këtë bazë në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatë nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimin e cekur më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP-i nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura PZAP-i vendosi si ne pjesën II te dispozitivit te vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga te dhënat e cekura si me larte e ne mbështetje te nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 781/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.